

V E N D I M
Nr. 221, datë 4.11.2002

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 10.10.2002 dhe 14.10.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 199 Akti që i përket:

KËRKUES: 1. XHAVIT BELIU, përfaqësuar nga avokate Liljana Ruli, me prokurë.

2. MUHAMER PAZARI, përfaqësuar nga avokat Riza Hicka, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: PETRIT KULLOLLI, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 8436, datë 17.10.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr. 991, datë 15.1.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 342, datë 22.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit dhe nr. X-4, datë 19. 12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit Xhavit Beliu dhe Muhamer Pazari, si përfaqësues të familjarëve të tyre në të njëjtin gjykim ndaj subjektit të interesuar Petrit Kullolli, me kërkesa të veçanta dhe me pretendime të ndryshme, por me objekt të njëjtë kanë, kërkuar përpara Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të sipërcituara.

Kërkuesi Xhavit Beliu parashtron këto shkaqe për antikushtetutshmërinë e këtyre vendimeve:

Së pari, është shkelur parimi procedural që gjykata duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet, por pa i kaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Gjykatat kanë vënë të paditurin në pozitën procedurale të kundërpaditësit, pa ngritur kundërpadi.

Së dyti, Gjykata e Kasacionit ka udhëzuar kthimin e çështjes për rigjykim dhe zbatimin e dispozitave të Kodit Civil aktual për marrëdhënie në fushën e pronësisë të lindura përpara hyrjes së tij në fuqi. Kodi Civil i vitit 1982 (që duhet zbatuar në këtë rast) nuk njihte fitimin e pronësisë me bashkim e përzierje.

Të gjitha pretendimet e tjera të kërkuesit lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave.

Kërkuesi Muhamer Pazari ka parashtruar në kërkesën e tij se nuk është në dijeni të zhvillimit të këtij gjykimi. Nëna e tij Maire Pazari figuron si palë e paditur në këtë gjykim, ndërkohë që ajo vetë nuk ka marrë pjesë, dhe as ka autorizuar ndonjë përfaqësues. Në dosje figuron një prokurë për familjen “Beliu”, në të cilën thuhet se Maire Pazari qenka përfaqësuar me prokurë nga Kadri Pazari. Kërkuesi pretendon se prokura në emër të Kadri Pazarit nuk ka ekzistuar ndonjëherë. Pra, sipas kërkuesit, është zhvilluar një gjykim ku nëna e tyre figuron si palë ndërgjyqëse, ndërkohë që ata vihen në dijeni për këtë gjykim në vitin 2002.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, përbërja e Gjykatës Kushtetuese, për arsye objektive, nuk ishte e plotë dhe mendimet e gjyqtarëve u ndanë në një mënyrë të tillë që nuk arrihej të votohej për ta zgjidhur atë përfundimisht.

Në këto kushte, duke qenë se mënyra e votimit ishte e tillë që ndikoi në mosmarrjen e një vendimi përfundimtar, si dhe duke qenë se ekziston mundësia që në të ardhmen me plotësimin e numrit të nevojshëm të vendimmarrjes së Gjykatës kjo çështje mund të rishqyrtohet përsëri, kërkesa duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f” dhe 132 të Kushtetutës, si dhe në nenin 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I :

- Refuzimin e kërkesës.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.